

VENDIM
Nr.1516, datë 19.11.2008

**PËR MIRATIMIN E LEJES, PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS
TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT, ME RRYMË TË VAZHDUAR, PORTO
ROMANO/DURRËS (SHQIPËRI) – CASAMASSIMA/BARI (ITALI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Porto Romano/Durrës (Shqipëri) – Casamassima/Bari (Itali).

2. Miratimin e lejes nr.3, datë 1.10.2008 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Porto Romano/Durrës (Shqipëri) – Casamassima/Bari (Itali)”, dhënë shoqërisë “ENEL Produzione S.p.A”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të ligjit nr.9776, datë 12.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar”, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.725, datë 7.11.2007 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit”.

I jepet shoqërisë anonime “ENEL Produzione S.p.A.”

Regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve të Romës, me kod fiskal dhe numër TVSH-je 05617841001, në datën 29.10.1998, me seli në Romë, rruga “Regina Margherita”, nr.125.